



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCES**



*100 Vjet Pavarësi*

---

**Njoftim për mediat**

**Autoriteti i konkurrencës përshëndet masat e marra mbi publikimin nga ana e Bankës së Shqipërisë në faqen e saj të internetit të komisioneve dhe normave të interesit për shërbimet dhe produktet e ofruara nga bankat**

**Tiranë 30 korrik 2012** – Autoriteti i Konkurrencës, përshëndet masat e marra nga Banka e Shqipërisë për publikimin e komisioneve dhe normave të interesit për shërbimet dhe produktet e ofruara nga bankat e nivelit të dytë, në faqen e saj të internetit. Një nismë e tillë do të rrisë transparencën në tregje si dhe do të zvogëlojë asimetrinë e informacionit ndërmjet klientëve të shërbimeve bankare dhe bankave. Rritja e transparencës do t'ju ofronte më shumë mundësi zgjedhje klientëve duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis bankave.

Këto masa janë në të njëjtën linjë me rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 174, Datë 25.01.2011 “Për disa rekomandime në lidhje me transparencën dhe komisionet e aplikuara në tregun e shërbimeve bankare”.